



Në mbështetje të nenit 9 paragrafi 1, nenit 5 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1., pika 1.1.1., nenit 12 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.5. dhe nenit 22, paragrafi 3 të Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, nenit 21 paragrafi 2 të Ligjit nr. 06/L-011, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik (tutje: Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit), nenit 11 paragrafi 4 dhe 5, si dhe nenit 12 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7. të Rregullores Nr. 03/2023, për Procedurat për Hetimet Administrative në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, me datë 26.03.2026, nxjerrë këtë:

V E N D I M

- I. Mbyllet rasti me Nr. APK-DPKI-ZSVQVL-0152, lidhur me pretendimet për konflikt interesi për punonjësit e Odës së Mjekëve të Kosovës, për arsye se Agjencia nuk ka kompetencë ligjore për trajtimin e pretendimeve të raportuesit.
- II. Ky vendim është përfundimtar në procedurën administrative dhe i njëjti publikohet në uebfaqen zyrtare të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit.

A r s y e t i m

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, përmes platformës raporto korrupsionin ka pranuar denoncimin për shqyrtim të konfliktit të interesit nga raportuesi i rastit i cili ka ngrit pretendime për shqyrtimin e konfliktit të interesit, citojmë raportimin;

"Besim Ajeti me pozitë zyrtar ligjor është djali axhës së Prokurorit të Odës dr Bajram Ajeti, pra konflikt interesi, edhe ndërmjet dy të lartëcekurve edhe Kryetarit dr Pleurat Sejdiu si nënshkrues i kontratës së punës. Arbënora Duriqi Bahtiri me pozitë zyrtare ligjore është gruaja e Blerton Bahtiri djali dajës i dr Pleurat Sejdiut, dhe poashtu kunata e Prof Elton Bahtiri anëtar i Revistës Mjeku, organ i Odës së Mjekëve të Kosovës. Valbona Manaj me pozitë zyrtare administrative është nusja e djalit të Dr Rexhep Manaj anëtar i Komisionit Qendror Zgjedhor në Odën e Mjekëve të Kosovës, si dhe koleg i dr Faik Shatri që punojnë në klinikën e njëjti private, dr Faik Shatri është kryetar i Këshillit Drejtues të Odës së Mjekëve. Gramoz Jakupi me pozitë aktuale Sekretar i Përgjithshëm është emëruar jashtëligjshëm në pozitë edhe tani me vendim edhe në periudhën korrik- dhjetor 2024 si Ud Sekretar, pra si përmbush kriteret siç kërkohen me akte ligjore dhe nënligjore në fuqi të RKS dhe po ashtu as me rregullore të brendshme të Odës. I njëjti është shpërblyer me këtë pozitë meqë vëllau i tij Arianit Jakupi-farmacist ish kryetar i Odës së Farmacistëve) ka punësuar në pozitën e zyrtarit administrativ në Odën e Farmacistëve Burim Lika i cili është vëllau i gruas së dr Pleurat Sejdiu, pra favorit

është kthyer me favor me konflikt interesi me qëllim përfitimin financiar për vehte apo personat e tjerë. Shkëmbim Braina me pozitë zyrtar ekzekutiv në Zyren e Kryetarit është pranuar pa përfillur procedurat e rekrutimit, pra pa plotësuar kriteret që për pozitën e tij kërkohet fakultet i përfunduar në fushat juridik, ekonomik, ndërsa i njejtë ende është student i fakultetit të ndërtimtarisë. Pra dr Pleurat Sejdiu ka nënshkruar kontratë me kërkesë të udhëheqëses për administratë znj Pajtime Vllasa që është familjare e Shkëmbim Braina, Gezim Fazliu i punësuar në pozitën zyrtar administrativ është i punësuar në Odë pa plotësuar kriterin e përvojës por vetëm që është djali i mikut të dr Pleurat Sejdiut, z. Fadil Fazliu. Elira Selimi e punësuar në pozitën e Zyrtares për Informim Publik është vajza e Nexhmije Selimit Drejtoreshë për Administratë në Inspektorat të Punës, e cila pa zhvillim të procedurave vetëm me një vendim është emëruar në këtë pozitë, si rrjedhojë e miqësisë së znj Nexhmije Selimi me dr Pleurat Sejdiu. Znj Selimi po keqpërdor edhe pozitën e saj në IP duke ndikuar përmes dhënies së urdhërave të inspektori i punës që ka lëndën time dhe i cili ka nxjerr raport në favor të ish punëdhënësit tim pa më kontaktuar fare mua si palë ankuese. Shyhrete Rrahmani Sejdiu me pozitë Zyrtare Administrative është gruaja e shokut të nënkryetarit dr Rrezart Halili dhe në atë pozitë është emëruar duke iu dhënë në dispozicion testi i intervistës me shkrim, si edhe ka ndodh në punësimet e secilit zyrtar të mësipërm, përveç sekretarit Gramoz Jakupi i cili është zgjedh jashtëligjshëm pa procedura të mirëfillta rekrutuese por vetëm me vendim të Këshillit Drejtues dhe atë me dt 31 dhjetor 2024, pra ditën e fundit të vitit kalendarik. Nexhmije Hoxha Hasani me pozitë asistente administrative është motra e anëtarit të Kuvendit të Odës së Mjekëve, Dr Enver Hoxha që ndryshe përkthehet konflikt i pastër i interesit. Çlirimtare Krasniqi me pozitë udhëheqëse e zyrës ligjore e punësuar gjatë muajit prill pa përfillur procedurat e rregullta ligjore të rekrutimit, duke iu dhënë në posedim paraprakisht testi i intervistës me shkrim, duke mos përmbushur kriterin bazë përvojën si menaxhere që kërkohet me akte juridike edhe të brendshme të institucionit e lëre me aktet e tjera. Dhe punësimi i saj ka ndodh për shkak se ajo është motra e Altin Krasniqit-bashkë partiakut të dr Pleurat Sejdiu të cilët gjatë gjithë fushatës zgjedhore të zgjedhjeve të fundit nacionale kanë qenë së bashku në tubime, Liridona Zeneli Miftari me pozitë zyrtare administrative është shoqe e anëtares së Komisionit për Licencim në Odë, dr Arbëresha Sylja. Mergime Krasniqi, me pozitë zyrtare për financa është familjare e bashkëshortes së dr Pleurat Sejdiu, znj Linda Likaj Sejdiu, Arditi Krasniqi me pozitë zyrtar administrativ poashtu është familjar i bashkëshortes së dr Pleurat Sejdiu, znj Linda Likaj Sejdiu. Visar Kastrati me pozitë IT është burri kunatës së dr Kreshnike Dedushi Hoti - Kryetare e Komisionit për Edukim Specialistik në Odën e Mjekëve të Kosovës. Visar Kastrati duke mos iu shmangur konfliktit të interesit në pozitën e IT të KQZ së RKS, dhe njëkohësisht zyrtar i IT në Odë ka rrjedh informata për procesin zgjedhor duke i raportuar rezultatet zgjedhore shefit të tij dr Pleurat Sejdiu. Pleurat Sejdiu, përveç emërimit të miqëve të tij të ngushtë në komisionet e përhershme ku vet ka qenë pjesë e procesit vendimmarrës i njejtë ka emëruar motrën e tij Dr Teuta Sejdiu Hasbahta në Komisionin për Edukim të Vazhdueshëm Profesional të OMK-së, në dy mandatet e tij si Kryetar i Odës. Si dhe në mandatin e dytë e emëron motrën e gruas së tij Dr Albina Likaj Imeri në Komisionin për Anëtarësim, Licencim dhe Rilicencim të Mjekut në OMK”.

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit pas pranimit të raportimit nga jashtë ka filluar procedurën e shqyrtimit të pretendimeve të ngritura. Pas shqyrtimit të pretendimeve dhe informacioneve të pranuar sipas detyrës zyrtare vlerëson se Agjencia nuk ka kompetencë për

trajtimin e pretendimeve për konflikt interesi sipas Ligjit nr.06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Kjo për shkak se me nenin (1 dhe 2) është përcaktuar qëllimi dhe fushëveprimi i Ligjit nr.06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në të cilën thuhet;

Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është forcimi i integritetit të sektorit publik dhe garantimi i kryerjes së detyrave publike në mënyrë objektive, të paanshme dhe transparente në shërbim të interesit publik nëpërmjet identifikimit, parandalimit, menaxhimit dhe zgjidhjes së konfliktit të interesave të zyrtarëve.

Fushëveprimi

Dispozitat e këtij ligji përcaktojnë parimet, rregullat dhe procedurat lidhur me sjelljet e lejuara dhe të ndaluara të zyrtarëve gjatë kryerjes së detyrës publike si dhe masat e parapara për shkeljen e dispozitave të përcaktuara në këtë ligj. Ky ligj rregullon gjithashtu procedurat për detyrimet e raportimit, masat për parandalimin, identifikimin, menaxhimin dhe zgjidhjen e rasteve të konfliktit të interesit publik dhe private të zyrtarit gjatë dhe pas ushtrimit të detyrës publike si dhe detyrat e përgjegjësitë e autoriteteve përgjegjëse.

Bazuar në Ligjin nr.06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, Oda e Mjekëve të Kosovës nuk hynë në kuadër të fushëveprimit të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

Sipas nenit 5 të Ligji nr. 04/L-050 për Odat e Profesionistëve Shëndetësor, odat janë organizata të pavarura profesionale që ushtrojnë veprimtari publike dhe kanë cilësinë e personit juridik.

Ndërsa, Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit rregullon parandalimin, trajtimin dhe menaxhimin e konfliktit të interesit për zyrtarët e sektorit publik që ushtrojnë funksione në institucionet publike. Në këtë kuptim shprehja institucion është përcaktuar me nenin 3 paragrafi 1.13 të Ligji nr.06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në të cilën shprehimisht thuhet;

1.13. Institucion – përfshin institucionet publike të nivelit qendror dhe lokal, ndërmarrjet e nivelit qendror dhe lokal në të cilat ekziston pjesëmarrje e kapitalit shtetëror ose vendor dhe institucionet e tjera të themeluara me ligj.

Funksionet udhëheqëse të odës nuk klasifikohen funksione që hyjnë në mesin e zyrtarëve të lartë publik, e as funksionet e të punësuarve të tjerë nuk klasifikohen si zyrtar të sektorit publik në kuptim të zbatimit të detyrimeve që dalin nga Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit zbatohet për zyrtarët e sektorit publik të cilët ushtrojnë funksione në institucionet publike.

Ky konstatim bazohet në nenin 1 dhe 2, nenin 3 paragrafi 1.3, 1.4, 1.5, dhe nenit 1.13 të Ligjit nr.06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

II Agjencia vendosi duke u bazuar në nenin 22 [Procedura administrative e Agjencisë për rastet e konfliktit të interesit], paragrafi 12 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit me të cilin është përcaktuar se: “Të gjitha vendimet që i nxjerr Agjencia lidhur me konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit publik dhe shkeljen e dispozitave të këtij ligji, përfshirë veprimet e ndaluara ose të kufizuara në ushtrimin e funksionit publik, ushtrimin e veprimtarive të tjera, papajtueshmëritë në ushtrimin e funksionit publik, duhet të respektohen nga zyrtarët dhe institucionet përgjegjëse. Ato bëhen publike në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.”, si dhe paragrafin 15 të këtij neni, me të cilin është përcaktuar se: “Vendimet e Agjencisë në lidhje me konfliktin e interesit janë përfundimtare në procedurë administrative.”

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: palët e pakënaqura kanë të drejtë të iniciojnë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore të Prishtinës, Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit ligjor prej tridhjetë (30) ditësh, nga data e pranimit të këtij vendimit.

Vendimi iu dërgohet:

- OMK - së
- Drejtorit të DPKI- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

